



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË

Nr. 2643/ Prot.

Tiranë më 03 . 12 . 2025

Lënda: Kthim përgjigje

SH. P. K

Adresa: Lagjia nr. 5, Rruga "Eskod 99", Kukës

Në përgjigje të kërkesës tuaj, me nr. 21/1 prot., datë 21.11.2025 "Kërkesë për informacion", protokolluar në DPM me nr. 2643 prot., datë 25.11.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ju bën me dije se:

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 126, datë 15.10.2020 "Për metrologjinë", i ndryshuar si dhe VKM nr. 261, datë 29.04.2022 "Për njësitë bazë të sistemit ndërkombëtar të njësive (SI), që do të përdoren në Shqipëri, njësitë që rrjedhin prej tyre, shumëfishat dhe nënfishat, njësitë shtesë të vendosura ndërkombëtarisht dhe mënyra e përdorimit të tyre", në Republikën e Shqipërisë mund të përdoren:

- a) njësitë e Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI), përfshirë shumëfishat dhe nënfishat e tyre;
- b) njësitë jashtë Sistemit Ndërkombëtar të Njësive në rastet e transportit ajror, detar, hekurudhor dhe nëse ato janë miratuar me konventa ndërkombëtare të ratifikuara.

Në legjislacionin në fushën e metrologjisë nuk parashikohet njësia matëse, me emërtesën "metër sterë".

Ju faleminderit,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Alkida Llaka

